



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E PEJËS
MUNICIPALITY OF PEJA
OPŠTINA PEČ



ZYRA E PROKURIMIT
KOMUNA E PEJËS

KONTRAT PUBLIKE KORNIZË

635-25-11406-2-1-1/C1262

KOMUNA E PEJES, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëren anë;

dhe

Grup i Operatorëve Ekonomik KE LUANI SH.P.K.; „Menti Sh.p.k., Fusha e Pejës, Pejë, (në vazhdim "Ofruesi i Shërbimeve"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për Shërbimet në vijim:

Mirëmbajtja dimërore e rrugëve në Komunën e Pejës LOT 2 Mirëmbajtja e rrugëve në fshatrat e Komunës së Pejës RITENDER me numër identifikues: **635-25-11406-2-1-1 dhe nr te brendshem 635/24/049/211**

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kësaj kontrate publike kornizë është që të themeloj kushtet, duke përfshirë çmimet për njësi dhe rregullat e implementimit për kryerjen e shërbimeve në vijim:

Mirëmbajtja dimërore e rrugëve në Komunën e Pejës LOT 2 Mirëmbajtja e rrugëve në fshatrat e Komunës së Pejës RITENDER

Nr.	Grupi
1	LOT 2 Mirëmbajtja e rrugëve në fshatrat e Komunës së Pejës RITENDER

1.2 Kontrata publike kornizë do të implementohet me "vendosjen e porosive" apo thirrje. P.sh. Kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Autoritet tjetër Kontraktues i përfshirë në këtë kontratë, tenton të blejë artikuj në bazë të kësaj kontrate publike kornizë, duhet që të dërgojë "porosinë" tek Ofruesi i shërbimeve, duke specifikuar listën e shërbimeve që duhet të performohen me sasi të tyre përkatëse.

1.3 Sasi të vlerësuara, të përcaktuara në Pjesën C. Lista e Çmimit, janë vetëm sasi indikative. Autoriteti(et) Kontraktues i përmendur në Nenin 1.1 është (janë) i(të) detyruar të përdorë(in këtë marrëveshje kornizë sa herë që të prokurorjshë shërbimet e përmendura në 1.1.


1.4 Kontrata hynë në fuqi me 21.01.2026 dhe përfundon në datën 21.01.2029

Neni 2 Koha e përfundimit

2.1 Afati kohor për kryerje të shërbimeve do të jetë **5** ditë nga koha e lëshimit të urdhër blerjes nga ana e Autoritetit Kontraktues.

2.2 Vendi i kryerjes së shërbimeve do të jetë Fshatrat e Komunes se Pejës

Neni 3 Çmimi



3.1 Çmimet njësi të shërbimeve janë paraqitur në Ofertën Financiare. Lista e Çmimit e paraqitur nga Ofruesi i Shërbimeve.

Vlera totale indikative e kontratës është **158,400.00** Euro. (Njëqind e pesëdhjetë e tetë mijë e katërqind euro).

Devijimi i lejuar nga vlera totale indikative është Plus/minus 30%.

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës publike kornizë.

3.3 Çmimet e njërive do të jenë fikse dhe nuk do të nënshtrohen ndryshimeve për porositë e vendosura nën këtë kontratë publike kornizë.

3.4 Pagesat do të bëhen në përputhje me Kushtet e Përgjithshme dhe/ose të Veçanta të Kontratës.

Neni 4 Rendi i përparësisë së dokumenteve të kontratës

4.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kontrata Publike Kornizë;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Ofruesit të Shërbimeve, duke përfshirë Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Lista e Çmimeve); 08.01.2026
- (f) Urdhër blerja;

4.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.


Neni 5 Komunikimet


5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Ofruesit të Shërbimeve nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të bëhen me shkrim. Komunikatat duhet të dërgohen me postë, mesazh, telefaks, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimi të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimi të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

5.3 Kudo që në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

5.4 Kjo kontratë është përgatitur në gjuhët Shqipe në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Ofruesin e Shërbimeve.

Për Autoritetin Kontraktues	
Emri:	Milot Gashi
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	21.01.2026
Vula:	

Për Autoritetin Kontraktues	
Emri:	Gazmend MUHAXHERI
Pozita:	Zyrtar Kryesor Administrativ
Nënshkrimi:	
Data:	21.01.2026
Vula:	



Për Kontraktuesin	
Emri:	Bujar Kelmendi
Pozita:	Perfaqesues i Konzorciumit
Nënshkrimi:	
Data:	21.01.2026
Vula:	



**PARAMASA DHE PARALLOGARIA - MIRËMBAJTJA DIMËRORE E RRUGËVE NË KOMUNËN E PEJËS
PER VITIN 2026/2029**

Loti II (Mirëmbajtja e rrugëve në fshatëra)

Nr	Përshkrimi	Njësia	Sasia (e planifikuar)	Çmimi	Shuma me tvsh
1	Pastrimi i rrugëve nga bora - pa hedhje të kripës (Për 20 herë pastrim të planifikuar 110*20 herë =2200 km x 3 vjet)Ne pozicion perfshihet edhe paisja e makinave me GPS ku duhet te kete qasje menaxheri I kontrates.	Km ¹	6600	7.00	46,200.00
2	Pastrimi i rrugëve nga bora - me hedhje të kripës, ku në këtë pozicion është kalkuluar edhe furnizimi i kripës, rërës si dhe përzierja dhe përgatitja e kripës për shpërndarje, e ku sasia e nevojshme e kripës duhet të bëhet duke pas parasysh kushtet klimatike dhe gjendjen e rrugëve. (Për 20 herë pastrim të planifikuar 110*20 herë = 2200km)Ne pozicion perfshihet edhe paisja e makinave me GPS ku duhet te kete qasje menaxheri I kontrates.	Km ¹	6600	17.00	112,200.00
Totali me tvsh					158,400.00



KUSHTET E PËRGJITHSHME

Neni 1 Përkufizimet

- 1.1 "Kontratë" do të thotë marrëveshja e lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve, siç është shkruar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shfaqjet për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkorporuar me referencë në të.
- 1.2 "Shërbimet" do të thotë shërbimet që do të ekzekutohen nga ana e Ofruesit të Shërbimeve në pajtim me Specifikimin dhe Përshkrimin e Çmimit të përfshirë në Tenderin e Ofruesit të Shërbimeve.
- 1.3 "Ofrues i shërbimeve" është Operatori Ekonomik ose grupi i Operatorëve Ekonomik, i caktuar në formularin e kontratës, që është palë në kontratë dhe i detyruar të kryej detyrat në bazë të marrëveshjes, dhe që për detyrat e kryera do të marrë shumën e rënë dakord në formularin e kontratës.
- 1.4 "Personeli" do të thotë personat e angazhuar nga Ofruesi i Shërbimeve ose nga Nën-kontraktuesi si të punësuar dhe të caktuar për kryerjen e shërbimeve ose të ndonjë pjesë të tyre.
- 1.5 "Çmimi i kontratës" do të thotë shuma e deklaruar në Marrëveshjen që përfaqëson shumën totale të pagesimeve për ofrimin e Shërbimeve.
- 1.6 "Nënkontraktues" do të thotë çdo person fizik, privat ose subjekt i qeverisë, ose kombinimi i tyre, duke përfshirë edhe pasardhësit e tij ligjor ose transferimet e lejuara, për të cilin çdo pjesë e Shërbimeve do të sigurohet ose ekzekutimi i ndonjë pjesë të Shërbimeve është nënkontraktuar nga Ofruesi i Shërbimeve.
- 1.7 "Palë" nënkupton Autoritetin Kontraktues ose Ofruesin i Shërbimeve, siç mund të jetë rast, dhe "Palët" nënkupton të dy prej tyre.
- 1.8 "Autoriteti Kontraktues" nënkupton autoritetin që bën Shërbimet, siç specifikohet në Kontratë.
- 1.9 "KPK" nënkupton Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.
- 1.10 "VKV" nënkupton Kushtet e Veçanta të Kontratës.

Neni 2 Gjykatë dhe ligji i aplikueshëm

- 2.1 VKV e vaktëson që çdo çështje që i përketkon të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluar në kontratë.
- 2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në VKV.

Neni 3 Transferimi

- 3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Ofruesi i Shërbimeve e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj të një palë e tretë.
- 3.2 Ofruesi i Shërbimeve nuk mundet që, pa miratimin paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, të transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfundim apo interes nga ajo, përveç në këto raste:
- a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të banorëve të Ofruesit të Shërbimeve, të shumave që duhet të paguhen ose të do të bëhen borch sipas kontratës; ose
 - b) në rast të dhënies së të drejtës së Ofruesit të Shërbimeve sipas rregullave të Ofruesit të Shërbimeve për të kështu pagesën nga ndonjë person, jetor i detyruar në rastet kur sigurimet e kësaj shkaktojnë humbjen ose detyrimin e Ofruesit të Shërbimeve.
- 3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do të jetë Ofruesi i Shërbimeve nga obligimet e veia për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është realizuar.
- 3.4 Promuesit e dispozitave të Kontratës duhet të përcaktojnë kriteret e përshkruarshëm që zbatohen për dhënien e kontratës për që në rastin e transferimit duhet të bankë apo kompani të sigurimit ose institucion gjyqësor financiar.

Neni 4 Nën-kontraktimi

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Ofruesi i Shërbimeve e ka bërë realizimin e një pjese të kontratës së tij një palë tjetër.

4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues me kushtin e dorëzimit të ofrës. Në rast të ndryshimit të nënkontraktuesve gjatë implementimit të kontratës, Ofruesi i Shërbimeve duhet të njoftojë me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do të lajmërojë Ofruesin e Shërbimeve për vendimin e vet brenda 30 ditësh pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsye të veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Ofruesi i Shërbimeve nuk nënkontraktën pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Të gjithë nënkontraktuesit e propozuar duhet të përmbushin kërkesat e përshatshmerisë.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njeri lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve, megjithatë mund të sigurojë, ku e konsideronë si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Ofruesit të Shërbimeve, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Autoritetit kontraktues nuk e lirton Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e tij sipas kontratës.

Neni 5 Tarifimi

5.1 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për të gjitha tarifimet dhe detyrimet doganore në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha tarifimet dhe detyrimet tjera doganore konsiderohet se janë përfshirë në çmimin e kontraktuar.

5.3 Menaxheri i Projektit do të harmonizojë çmimin e kontraktuar nëse konstaton se ka ngrihje të tarifave dhe detyrimeve doganore brenda datës prej 28 ditësh para dorëzimit të tenderit dhe datës së fundit të vlerësimit të ekzekutimit të shërbimeve.

5.4 Menaxheri i Projektit nuk do të lejojë ndryshimin e çmimit të kontraktuar për shkak të ngrihjes së tarifave dhe/ose ngrihjes së detyrimeve doganore në qoftë se kjo ka ndodhur gjatë kohës së kaluar në vonesë Ofruesi i Shërbimeve.

Neni 6 Fillimi dhe Ekzekutimi i shërbimeve

6.1 Ofruesi i Shërbimit duhet të fillojë shërbimet sa më shpejt që është e arsyeshme e mundur pas marrjes së urdhrit me ekspeditën e cunur dhe pa vonesë.

6.2 Ofruesi i Shërbimeve do të përfaqësojë aktivitetet veprimtari brenda aratit kohor të specifikuar në Nenin 2.18 Formularit të Kontratës. Nëse Ofruesi i Shërbimeve nuk i përfundon aktivitetet në datën e caktuar, ai do të jetë përgjegjës për të paguar dëmet e likuiduara. Në këtë rast, Data e Përfundimit do të jetë data e përfundimit të të gjitha aktivitetëve.

Neni 7 Zgjatja e periudhës së ekzekutimit

7.1 Ofruesi i Shërbimit mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vuan nga, ose priret se do të vuan, për ndonjërin nga këto arsye:

- a) dështimi i Autoritetit Kontraktues për të përmbushur detyrimet e tij sipas kontratës;
- b) forcë majore e cila përfshihet në parim të:

7.2.2 Brenda 15 ditëve me të kaluar se një vonesë mund të ndodhë, Ofruesi i Shërbimeve do të njoftojë Autoritetin Kontraktues me qëllimin e tij që të bëjë një kërkesë për zgjatje të periudhës së realizimit për të bërë një kontraktim të ri të shërbimit dhe, përveçse kur është rëndësishme, ndërmjet ofruesit të shërbimeve dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditëve nga e njëjta pikë në kohë të sigurojë Autoritetin Kontraktues me ndihesit të , dhe të mënyrë që të mund të shqyrtohet kërkesa.

7.3 Brenda 30 ditëve nga marrja e hollësive të përmendura në 7.2, Autoriteti Kontraktues me anë të një lloji të mos shkrimit do t'i lejoi Ofruesit të Shërbimeve zgjatjen e periudhës së ekzekutimit siç mund të arsyëtohet, ose në mënyrë retrospektive dhe retrospektive, ose të informoj Ofruesin e Shërbimeve që ai nuk ka të drejtë në zgjatje.

Neni 8 Forcë Madhore

8.1. Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë shkelje të obligimeve të saj sipas kontratës nëse realizimi i obligimeve të tilla parandalohet nga ndonjë ngjarje e shkaktuar nga një forcë *madhore* që shkaktohet pas datës së njoftimit me çështje të kontratës ose kur kontrata lyp në fakt.

8.2. Termi "forcë madhore" do të thotë veprimet e zotit, goditjet, rrylljet e objektit ose qrrëgjilimet (jerr industriale, veprimet e armikut publik, luftërat gëfishin të deklaruar ose jo, bllokadat, rrethimet, rastei e dhunës, epidemitë, rrëshqitjet e tokës, tërmetet, shtrëngatat, vetëtimat, vërshimet, erozionet, trazirat civile, eksplodimet dhe ndonjë ngjarje tjetër e ngjashme e paparashikuar që është përtej kontrollit të palëve dhe nuk mund të përballohet as me kujdesin e duhur.

8.3. Pala e ndikuar nga një ngjarje e forcës madhore do të marrë të gjitha masat e arsyeshme për të mënjanuar paartësinë e një pale të tilla që të përmbushë detyrimet e saj tani e tutje me një vonesë minimale.

8.4. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të jetë përgjegjës për dëmet e likuiduara ose ndërprerje nëse vonesa e tij në realizimin ose dështimi për të realizuar obligimet e tij me kontratë është rezultat i një ngjarjeje të forcës madhore. Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i detyruar të paguajë interes për pagesat e vonuara për mosrealizim ose ndërprerje nëse vonesa e Autoritetit kontraktues ose lloji tjetër i dështimit për të kryer obligimet e tij është rezultat i forcës madhore.

8.5. Nëse ndonjëra palë konsideron se ndonjë mosharë e forcës madhore ka ndodhur e cila mund të ndikojë në realizimin e obligimeve të saj, menjëherë do ta lajmërojë palën tjetër, duke dhënë të dhëna deriye mbi natyrën, kohëzgjatjen e mundshmë dhe efektin që kanë gjase ta kenë mosharën. Përveç kësaj udhëzohet ndryshe nga Menaxheri i Projektit me shkrim. Ofruesi i Shërbimeve do të vazhdojë t'i realizojë obligimet e tij sipas kontratës përderisa është mijat praktikë dhe të angazhojë të gjitha mjetet e arsyeshme alternative për të plotësuar ndonjë obligim që ngjarja e forcës madhore të mos e pengojë atë gjatë punës. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të zotëtojë njëllo të tilla alternative përveç nëse udhëzohet ta bëjë kështu nga Menaxheri i Projektit.

Neni 9 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti Kontraktues

9.1. Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Ofruesit të Shërbimeve 14 ditë paralajmërim, ta ndërprerë kontratën në ndonjërin nga rastei e mëposhtme:

(a) Ofruesi i Shërbimeve dështon në përmbushjen brenda një muni të arsyeshmë të paralajmërimin të dhënë nga autoriteti kontraktues që kërkon nga ai të evlojë ndonjë neglizhencë apo dështim për të realizuar obligimet e veta sipas kontratës, dhe të cilat ndikojnë në mënyrë serioze në realizimin e duhur dhe me kohë të shërbimeve;

(b) Ofruesi i Shërbimeve refuzon ose është neglizhent në realizimin e urdhrave administrativë të dhënë nga autoriteti kontraktues;

(c) Ofruesi i Shërbimeve ia jep dikujt kontratën apo nënkundatën pa autorizim nga Autoriteti kontraktues;

(d) Ofruesi i Shërbimeve çollimton ose është duke u rryllim burët e tij jurë duke u administruar nga gjykatat, kur kyç në marrëveshje me kredituesin, ka pozuar aktivitetet biznesore, i nënshtrohet procedurave ligjore të cilat me ato çështje, ose është në ndonjë si urë analoge që shkaktohet nga ndonjë procedurë e ngjashme e paratë të regjistracionit apo në rregullimet ndalimor;

(e) Ofruesi i Shërbimeve është dënua për një shkelje që ka të bëjë me sjelljen profesionalë, përmes një gjyqimi që ka fuqinë e *res judicata*;

(f) Ofruesi i Shërbimeve është shpallur fajtor për sjellje të rëndë të keqe jo profesionale të dështuar me qëllim, njëri që d'lin mund ta vërtetoj Autoriteti kontraktues;

(g) Ofruesi i Shërbimeve i është nënshtruar një gjykitimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korupsion, përshikje në ndonjë organizatë kriminale;

(h) të gjitha modifikimet organizative që përfshijnë ndryshime në personalitetin ligjor, natyror ose kontraktual të Ofruesit të Shërbimeve, përveç nëse këto modifikime regjistrohen në suplementin e kontratës;

(i) shfaqet ndonjë paafësi tjetër ligjore që i pengon realizimin të kontratës;

(j) Ofruesi i Shërbimeve nuk arrin të japë garancinë ose sigurimin e kërkuar, ose nëse personi që e jep garancinë apo sigurimin më të hershëm të kërkuar në kontratë e marrëshme nuk është në gjendje t'i plotësojë obligimet e tij;

9.2 Ndërpërja do të bëhet pa paragjykim ndaj të drejtave apo mundësive tjera të Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës. Autoriteti kontraktues, pas kësaj mund të nënshkruajë ndonjë kontratë tjetër me një palë të tretë në emër të Ofruesit të Shërbimeve.

9.3 Autoriteti Kontraktues, pas tëshimit të njohimit të ndërpërjes së kontratës, do ta ndërhojë Ofruesin e Shërbimeve që të ndërmarrë hapa të menjëhershëm për ta përmbyllur ekzekutimin e shërbimeve në mënyrë të shpejtë dhe të rregullt dhe për t'i zvogëluar në minimum shpenzimet.

9.4 Në rast të ndërpërjes, autoriteti kontraktues, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në prani të Ofruesit të Shërbimeve ose të përfaqësuesve të tij ose duxo të bërë atyre thirrjen e duhur, do ta përgatisë një raport mbi shërbimet e kryera. Do të përgatitet edhe një deklaratë e parave që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve dhe parave që i ka borxh Ofruesi i Shërbimeve Autoritetit kontraktues në datën e ndërpërjes së kontratës.

9.5 Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i obliguar të bëjë pagesa tjera për Ofruesin e Shërbimeve derisa të janë përfunduar shërbimet, ndërsa Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve koston ekstra, nëse ka, për të siguruar ofruesin e shërbimeve ose do të paguajë shumën që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve para ndërpërjes së kontratës.

9.6 Nëse Autoriteti kontraktues e ndërpret kontratën, ai do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve humbjet që i janë shkakuar nën kushtet e kontratës.

Neni 10 Ndërpërja e Kontratës nga Ofruesi i Shërbimeve

10.1 Ofruesi i Shërbimeve, pasi e ka paraqajmëruar Autoritetin kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpretë kontratën nëse Autoriteti kontraktues:

a. nuk arrin t'i paguajë Ofruesit të Shërbimeve shumën që duhet të paguhet në ndonjë certifikatë të lëshuar nga personi i autorizuar pas studiimit të afërt të fundit;

b. vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta edhe pas rikujtimeve të përsëritura; ose

c. ose, si rezultat i Forcës Madhore, Ofruesi i Shërbimeve është i paafë të kryej një pjesë materiale të Shërbimeve për një periudhë prej jo më pak se gjashtëdhjetë (60) ditë.

10.2 Ndërpërja do të bëhet pa paragjykim për ndonjë të drejtë apo autoritet tjetër sipas kontratës së Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve.

10.3 Në rast të ndërpërjes sipas paragrafit (a) dhe (b) të Seksionit 10.1, Autoriteti kontraktues do të paguajë Ofruesin e Shërbimeve për humbje ose dëm që mund t'i jetë shkakuar Ofruesit të Shërbimeve.

Neni 11 Obligimet e Ofruesit të Shërbimeve

11.1 Ofruesi do të kryejë Shërbimet sipas koartës me kujdes, efikasitet dhe zell, në përputhje me praktikën e praktikave më të mira profesionale.

11.2 Ofruesi i Shërbimeve duhet të pajtohet me udhëzimet administrativë të dhëna nga Autoriteti Kontraktues, konstatues i shërbimeve konsideron se kërkesa e një udhëzimi administrativ shkon përtej detyrës qëndron në kontratë, që

duke iu ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit. Ekzekutimi i urdhrit administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

11.3 Ofruesi i Shërbimeve duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmit e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

11.4 Ofruesi i Shërbimeve do të trajtojë të gjitha dokumentet dhe informacionet e marra në lidhje me kontratën si private dhe konfidenciale. Ai nuk do të shpëtojë për aq kohë sa të jetë e nevojshme për qëllimet e ekzekutimit të kontratës, të botojë ose të zbulojë ndonjë të dhënë të kontratës, pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues.

11.5 Nëse ofruesi i shërbimit është një konsorcium i dy ose më shumë personave ose korporatave, të gjithë personat ose korporatat e tilla do të jenë së bashku dhe veçmas të detyruar për të përmbushur kushtet e kontratës. Personi i caktuar nga konsorciumi për të vepruar në emër të tij për qëllimet e kësaj kontrate do të ketë autoritetin për të lidhur konsorciumin. Përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues.

11.6 Ofruesi i Shërbimeve do të punësojnë personelin kyç të identifikuar në tenderin e tij për të kryer funksionet e përcaktuara në tenderin e tij. Për më tepër, gjatë performancës, dhe në bazë të një kërkesë me shkrim dhe të arsyetuar, autoriteti kontraktues mund të kërkojë një zëvendësim nëse vlerëson se një anëtar i stafit është i paefektshëm ose nuk kryejnë detyrat e tij sipas kontratës. Autoriteti Kontraktues do të miratojë çdo zëvendësim të personelit kryesor të propozuar vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse dhe aftësitë në thelb janë të barabarta ose më të mirë se ato të identifikuara.

Neni 12 Obligimet e Autoritetit Kontraktues

12.1 Autoriteti Kontraktues do të ofrojë ofruesit të shërbimit menjëherë me ndonjë informacion dhe / ose dokumente në dispozicion të saj, të cilat mund të jenë relevante për zbatimin e kontratës. Dokumente të tilla duhet ti kthehen Autoritetit Kontraktues në fund të periudhës së zbatimit të detyrave.

12.2 Autoriteti Kontraktues do të bashkëpunojë sa më shumë të jetë e mundur me ofruesin e shërbimit për të siguruar informacion që ky i fundit mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme për të kryer kontratën.

12.3 Autoriteti Kontraktues do të caktoj *"Menaxherin e Projektit"*, i ceku në KVK, i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së shërbimeve gjatë gjithë kohës dhe për raportimin e çdo hollësie Autoritetit Kontraktues.

Neni 13 Dëmet e Likuiduara

13.1 Nëse Ofruesi i shërbimeve me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0.25% në ditë të vlerës së shërbimeve të pa kryera deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të porosisë. Autoriteti Kontraktues mund të zbresë dëmet e likuiduara nga pagesat të cilat duhet ti behen Ofruesit të Shërbimeve. Pagesat e dëmeve të likuiduara nuk do të prekin detyrimet e Ofruesit të Shërbimeve.

13.2 Nëse mos-ekzekutimi i ndonjërit shërbime parandalon përdorimin e zakonshëm të shërbimeve në tërësi, dëmet e likuiduara të parapara në paragrafin 13.1 do të llogariten në bazë të vlerës totale të porosisë.

13.3 Nëse Autoriteti kontraktues ka fituar të drejtën të kërkojë së paku 10 % të vlerës së porosisë ai mundet, pasi ta njoftojë me shkrim Ofruesin e Shërbimeve të:

a. Në rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetëm në emër të vetë Autoritetit, me një operatore ekonomik:

- konfiskojë garancinë e performancës;
- të ndërpresë kontratën, dhe në këtë rast Ofruesi i Shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim; dhe
- të hyjë në një kontratë me një palë të tretë për dhënien e pjesës së mbetur të shërbimeve. Ofruesi i shërbimeve nuk do të paguhet për këtë pjesë të kontratës. Ofruesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë

koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij).

b. Në rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar ratem në emër të vetë Autoritetit, me disa operatore ekonomikë:

- të konfiskojë garancinë e realizimit;
- të ndërpresë porosinë, dhe në këtë rast Ofruesi i Shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofruesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- të rif hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kontrazë.

c. Në rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar në emër të disa Autoriteteve tjera Kontraktuese, me një operatore ekonomik:

- Autoriteti Kontraktues i cili ka bërë porosinë anulon porosinë dhe ritenderon, dhe në këtë rast Ofruesi i Shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofruesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- të njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues i përmendur që të konfiskoje një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% të porosisë së lëshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues.

d. Në rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar në emër të disa Autoriteteve tjera Kontraktuese, me disa operatore ekonomik:

- të njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga nga Autoriteti Kontraktues i përmendur që të konfiskoje një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% të porosisë së lëshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues;
- të ndërpresë porosinë, dhe në këtë rast Ofruesi i shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofruesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- të rif hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kontrazë.

Neni 14 Siguria e Ekzekutimit

14.1 Ofruesi i shërbimeve do të jetë me vënd se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mirë të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo numbjete që tshirë pasqje e mos ekzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Ofruesit të Shërbimeve.

14.2 Garancia do të vazhdojë të mbetet i vlefshëm 30 ditë pas lëshimit të Certifikatës së Përfundimit.

14.3 Garancia e ekzekutimit të kontratës do të jetë në formën e dhënë në Pjesën IV të kësaj kontrate.

Neni 15 Sigurimi që do të merret nga Ofruesi i Shërbimit

15.1 Ofruesi i Shërbimeve do të marr dhe do të ruaj, dhe do të shkatoj Nënkontraktuarit të marrin dhe ruajnë me shpejtëzimet e tyre, por në bazë të kushteve të miratuara nga Autoriteti Kontraktues, sigurimin nga traziteti dhe përbullim, siq do të specifikohet në KVK.

15.2 Ofruesi i Shërbimeve, me kërkesë të Autoritetit Kontraktues, do të ofroj dëshmi për Autoritetin Kontraktues, që sigurimi i tillë tshirë marrë dhe ruajtur dhe se primet e tansure janë paguar.

Neni 16 Parimet të përgjithshme të pagesave

16.1 Pagesat do të bëhen në Euro. Pagesat që duhet të bëhen sipas figurës së lëshuar nga Ofruesi i Shërbimeve do të bëhen në degjara të bankare të dhënë në Pjesën VI, Specifikimi Financier, i kësaj kontrate që e plotëson Ofruesi

i Shërbimeve, i njëjti formular që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i nisur ndryshimet në llogarinë bankare.

16.2 Shuma duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh kalendrike nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

16.3 Periudha prej 30-ditësh mund të pezullohet duke e lajmëruar ofruesin e Shërbimeve që kërkesa për pagesë nuk mund të plotësohet sepse shuma nuk do të paguhet për shkak se nuk janë dorëzuar dokumentet e duhura përmbajtësore ose sepse ka dështim që shpenzimi mund të mos jetë i legjitim. Në rastin e fundit mund të bëhet një inspektim i menjëhershëm për qëllim të kontrollimeve tjera. Ofruesi i Shërbimeve do të japë sqarime, modifikime apo informata të tjera brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha e pagesës do të llogaritet nga data në të cilën është regjistruar kërkesa për pagesë e përgatitur në mënyrën e dukur.

16.4 Pas qortë të katë kaluar afati i fundit i dhënë në Nenin 16.2, Ofruesi i Shërbimeve mundet që brenda dy muajsh pas pagesës së vonuar, të kërkojë interesin për pagesë të vonuar me normë të re-zonijë që zbatohet nga Banka Qendrore e Kosovës në ditën e parë të muajt në të cilin ka skaduar afati i fundit, plus shatë pikë të përqindjes. Interesi për pagesë të vonuar do të zbatohet për kohën që kalon ndërmjet datës së afatit të fundit të pagesës (nuk përfshihet) dhe datës në të cilën debitohet llogaria e Autoritetit kontraktues (përfshihet).

16.5 Të gjitha mos pagesat pas 90 ditësh nga skadimi i periudhës së dhënë në Nenin 16.2 do t'i jepen të drejtë Ofruesit të Shërbimeve që, ose të mos e realizojë kontratën, ose ta ndërpresë atë, me paraqitje të 30 ditësh për Autoritetin kontraktues.

16.6 Në rast se Autoriteti kontraktues kryen blerje në emër të autoriteteve të tjera kontraktuese, dhe një autoritet kontraktues nuk i përmbush detyrimet e tij sipas kësaj kontrate, veçanërisht obligimet e Nenit 16.2 ofruesi i shërbimeve mund të informojë AQP-në për shkak të kësaj. AQP-ja mund të ndalojë autoritetin kontraktues nga përdorimi i qdo dhe të gjitha kontratat qendrore publike kombë të nxjerra nga AQP.

Neni 17 Kualiteti i Kontrollit

17.1 Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të Shërbimeve nga Autoriteti kontraktues do të jenë si në NVM. Autoriteti kontraktues do të kontrollojë punën e ofruesit të shërbimeve dhe të njohojë më për qdo defekt që është gjetur. Kontrolli i tillë nuk do të ndikojë në përgjegjësi të ofruesit të shërbimeve. Autoriteti Kontraktues mund të udhëtojë ofruesit e shërbimeve të kërkojnë një defekt dhe të zbulojnë dhe provojnë qdo shërbim që Autoriteti Kontraktues konsideron se mund të ketë një defekt. Periudha garantuere e defekteve është siç është përcaktuar në NVM.

Neni 18 Përmirësimi i Defekteve

18.1 Autoriteti kontraktues do të njohojë ofruesit e shërbimeve për qdo Defekt para përfundimit të kontratës. Periudha garantuere e defekteve do të zgjatet për atë kohë sa Defekti të korrigjohet.

18.2 Sa herë njohimi për një defekt është dhënë, ofruesi i shërbimeve duhet të përmirësojë cilësitin e njohur brenda kohës së specifikuar në njohimin e Autoritetit Kontraktues.

18.3 Nëse ofruesi i shërbimeve nuk e ka korrigjuar defektin brenda kohës së specifikuar në njohimin e Autoritetit Kontraktues, Autoriteti Kontraktues do të vlerësojë koston e korrigjimit të defektit, ofruesi i shërbimeve do të japë një kosto shumë, dhe do bashkë një dënim për mangësi Ekonomik në llogaritë siç përcaktohet në nenin 12.

Neni 19 Konsekuenca e Saktësisë së Kontratës

19.1 Pasi ka shpallë kontratën nëse nuk arrijnë të shijojë ndonjë nga obligimet e vendimeve kontratë siç është cekur në Nenin 9 dhe 10.

19.2 Në rastin kur ndodh një saktësi e kontratës, pala e dështuar do të ketë të drejtë për koston kompensuese

- a) dëmet dhe/ose
- b) ndërprerje të kontratës.

19.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ata mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

19.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen duhet të zbatohen duke u zëritur nga shumat që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve, nga depozita, ose me pagesë nga siguria.

Neni 20 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

20.1 Palët duhet t'i bëjnë të gjitha përpjekje për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për qëndrimin e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado palë e sheh të dëshimë, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse pala dëshiron të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

20.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përploen të pajtohen, përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 21 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

21.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) vendim nga gjyqi; ose
- b) kurdo që palët pajtohen, vendim arbitral në pajtim me KVK.

21.2 Para nënsakrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjyqësor apo arbitral.

Neni 22 Dëmshpërblimi

22.1 Ofruesi i shërbimeve do të mbrojë dhe do të dëmshpërblijë Autoritetin Kontraktues, zyrtarët e tij dhe vizitatorët, drejtorët, punonjësit dhe agjentët e tij dhe do të jetë përgjegjës për të gjitha shpenzimet, humbjet, dëmet dhe pagesat e shkakjuara nga Autoriteti Kontraktues, duke përfshirë por jo kufizuar shpenzimet e marrëveshjeve, avokateve dhe shpenzimet në lidhje me neglizhencën ose keqpërdorimet e qëllimshme nga ana e ofruesit të shërbimeve, shkeljet apo shkeljet e pretenduar nga prozantimet e Ofruesit të Shërbimeve, pretendimet nga një palë tjetër se sigurtimi i tyre, shërbimeve nga ofruesi i shërbimeve apo shërbimet e tyre nga apo në emër të Autoritetit Kontraktues apo përdorimit ose sigurimit i ndonjë aseti të siguruar nga ofruesi i shërbimeve në lidhje me çështjen e shërbimeve shkel të drejtat e pronësisë intelektuale të asaj pale tjetër.

KUSHTET E VEÇANTA
635-25-11406-2-1-1/C1262

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë gjuha Shqipe .
Obligimet e Autoritetit Kontraktues	12.3	Menaxheri i Projektit është 1. ILIR KELMENDI
Siguria e ekzekutimit	14.1	Sigurimi i ekzekutimit 10 % e vlerës së kontratës (nga banka apo kompanite e sigurimeve) ne shume prej 15,840.00 euro me afat nga data 21.01.2026 deri me datë 21.02.2029
Sigurimi që do të merret nga ofruesi i shërbimit	15.1	Rreziqet dhe mbulesat nga sigurimi do të jenë: a) Mjetet motorike të Palës së Tretë b) Përgjegjësia e pales së tretë c) Përgjegjësia e punëdhënësit dhe kompensimi i punonjësve d) Përgjegjësia profesionale e) Humbje ose dëmtim të pronës dhe pajisjeve
Kualiteti i Kontrollit	17.1	Parimi dhe modalitetet e inspektimit të shërbimeve nga Autoriteti Kontraktues janë si më poshtë: Periodha e përgjegjësisë së Defekteve N/A
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	20.2	
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	21.1	<i>Kurdo që palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të Tribunali i Përhershëm i Arbitrazhit të Kosovës në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës, në përputhje me rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë.</i>



ELSIG

Kompania e Sigurimeve Sh.A./Insurance Company J.S.C.

Gjithcka që duhet ta keni

Deklaratë e Garantuesit

SIGURIA E EKZEKUTIMIT

Pjesë përbërëse e Polices me Nr. 147914

Për **KOMUNA E PEJËS**

(Emri i "Autoritetit Kontraktues")

Në emër të **KE LUANI SH.P.K.**

(emri dhe adresa e "Operatori Ekonomik" dhe nr. i biznesit në vazhdim Operatori Ekonomik)

Titulli i aktivitetit të prokurimit: **Mirëmbajtja dimërore e rrugëve në Komunën e Pejës LOT 2 Mirëmbajtja e rrugëve në fshatrat e Komunës së Pejës RITENDER**

Nr. prokurimit: 635-25-11406-2-1-1, Nr. brendshëm: 635/25/049/211

Garancion me kërkesë të parë

Derisa operatori ekonomik i lartëcekur, ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri të ekzekutimit duke iu referuar dosjes së tenderit me numër të prokurimit të lartëcekur të dërguar nga autoriteti kontraktues, dhe ngase tenderuesi dëshiron të depozitoi garancinë në shumën e saktësuar në dosjen e tenderit, dhe ngase jemi pajtuar t'i japim tenderuesit këtë garanci.

Andaj me këtë konfirmojmë se jemi garantues dhe përgjegjës para jush, në emër të operatorit ekonomik, deri në një shumë totale: **15,840.00€** zotohemi të ju paguajmë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet mospërputhja e njërit nga kushtet në vijim:

- Autoriteti kontraktues konstaton në bazë të dëshmive të vertetuara objektivisht se operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe kjo i ka shkaktuar autoritetit kontraktues dëme substanciale dhe/ose shpenzime të mëdha për mbylljen e kontratës në fjalë, dhe;
- Operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe si rezultat i saj kanë mbet pa u paguar shumë punëtorë, nënkontraktorë dhe/ose furnizues të materialeve.

Pagesa në shumën e limituar prej **15,840.00€** siç është lartëcekur, pa pasur nevojë të vertetoni apo të tregoni arsyet ose shkaqet e kërkesës tuaj, apo për shumën e specifikuar këtu.

Kjo siguri vlenë 1127 ditë kalendarike prej **21.01.2026** deri më **21.02.2029**

Me plotësimin e detyrimeve ndaj Përfituesit të Garancionit, Siguruesit/Garantuesit i kalon e drejta për ta rimbursuar nga i Siguruari/Kontraktuesi shumën e paguar përfituesit, me të gjitha të drejtat dhe mjetet ligjore deri në përmbushjen e tërësishme të detyrimeve.

Data lëshimit: 21.01.2026

Nënshkrimi dhe yula e garantuesit



Ky garancion i nënshtrohet rregulleve uniforme për garancione (URDG), botim 2010, Publikimi ICC Nr. 758.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E PEJËS
MUNICIPALITY OF PEJA
OPŠTINA PEČ



ZYRA E PROKURIMIT KOMUNA E PEJËS

KOMUNA E PEJËS

Zyrtari Kryesor Administrativ

Datë: 21.01.2026

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 të Ligjit Nr.03/L-40 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), si dhe në pajtim me nenin 81 të Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurim Publik në Republikën e Kosovës, Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik / Nr.A01, në bashkëpunim me dhe propozim të Përgjegjësit të Njësisë Kërkuese dhe Drejtorit të Drejtorisë për Prokurim Publik, më dt. 15.02.2023 merr:

V E N D I M

- I. Emërimin e Menaxherit të Kontratës
- II. Emërimin e Mbikëqyrësit të Drejtpërdrejt të Menaxherit të Kontratës

Mirëmbajtja dimërore e rrugëve në Komunën e Pejës LOT 2 Mirëmbajtja e rrugëve në fshatrat e Komunës së Pejës RITENDER me numër të prokurimit: 635-25-11406-2-1-1 Numri i kontratës: : 635-25-11406-2-1-1/C1262 dhe numri i brendshëm i prokurimit: 635/24/049/211

- i. Menaxher i Kontratës caktohet:
1. ILIR KELMENDI Zyrtar për Infrastrukturë rrugore, Drejtoria për Shërbime Publike Komuna e Pejës
- ii. Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës caktohet:
AGRON NIKQI Drejtorë në Drejtoratin e Shërbimeve Publike dhe Punë Komunale

Përgjegjësitë dhe funksionet e [Menaxherit të Kontratës], janë që të :

- a) Në pajtim me nenin 61.7 të rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik, pas pranimit të Njoftimit për emërim si menaxher i kontratës, menaxheri i Kontratës duhet të kyçet në Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe duhet të filloj me fazat e menaxhimit të Kontratës nëpërmjet funksioneve për menaxhim të kontratës. Si fazë e parë Menaxheri i kontratës brenda afatit duhet të krijoj Planin për Menaxhim të kontratës duke përdorur funksionin "Fillimi / mobilizimi i kontratës;
- b) Menaxhojë obligimet dhe detyrat e Autoritetit Kontraktues të specifikuar në Kontratë;
- c) Sigurojë që Operatori Ekonomik përmbushë të gjitha obligimet e performances apo dërgesës në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- d) Sigurojë që Operatori Ekonomik dorëzon tërë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- e) Sigurojë që Komuna i përmbushë gjitha pagesat dhe obligimet tjera në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- f) Sigurojë se ka kontroll adekuate të kostove, cilësisë dhe kohës;
- g) Sigurojë që të gjitha obligimet janë kompletuar para mbylljes së dosjes së Kontratës;
- h) Sigurojë që të gjitha regjistrat e menaxhimit të kontratës të mbahen dhe arkivohen në modulën për menaxhim të kontratës në sistem të prokurimit elektronik;
- i) Bëj vlerësimin e performances së operatorit ekonomik në sistem të prokurimit elektronik pas përfundimit të kontratës

- j) Nxjerrë variacione apo urdhra për ndryshim nëse kërkohet, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës dhe legjislacionin për natyrën e aktivitetit;
- k) Sigurojë detaje të plota të një ndryshimi të kërkuar të kontratës Departamentit të Prokurimit dhe ta marr miratimin;
- l) Të menaxhojë dorëzimin e procedurave të pranimit;
- m) Jep detaje të plota për ndonjë ndërprerje të propozuar të kontratës Departamentit të Prokurimit;
- n) Dorëzoj raporte mbi progresin ose kompletimin e një kontratë, siç kërkohet nga Departamenti i Prokurimit ose nga Zyrtari Kryesor administrativ.

Përgjegjësitë dhe funksionet e Mbikëqyrësit të Drejtpërdrejt të Menaxherit të Kontratës, janë:

- a) mbikëqyrja e drejtpërdrejtë e implementimit të kontratës;
- b) administrimi i plotë i kontratës, përfshirë çfarëdo ndryshimi eventual të kontratës, dhe
- c) rishikimi, aprovimi dhe procesimi i vlerësimit të performances se operatorit ekonomik të propozuar nga menaxheri i kontratës.

3. Vendimi hyn në fuqi dhe zbatohet ditën e marrjes.

Kopje: Menaxheri i Kontratës;
 [Ekipit për menaxhim të kontratës]
 [Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i Menaxherit të Kontratës];
 Drejtorisë së Prokurimit;
 Drejtorit të Njesisë Kërkuese


 Zyrtari Kryesor Administrativ
 Gazmend Muhaxheri